



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

“KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT”

RREGULLORE

**“PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE
DHE DEKLARIMIN E PASURIVE
NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE”**

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit”, bazohet në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe në ligje apo akte nënligjore të tjera, të veçanta e për të njëjtin qëllim.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, nëpërmjet parandalimit të konfliktit midis interesave publikë dhe atyre privatë të një funksioni publik në ushtrimin e detyrave të veta, të lidhura me misionin dhe veprimtarinë e Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.

Neni 3 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Neni 4 Përkufizime

1. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një funksionari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike, të lidhura me misionin dhe veprimtarinë e Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.

Konflikti i interesit përfshin edhe disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) “Konflikt faktik i interesit” është gjendja në të cilën interesat private të funksionarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

b) “Konflikt në dukje i interesit” është gjendja në të cilën interesat private të funksionarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij publike, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.

- c) “Konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja në të cilën interesat private të funksionarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse funksionari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.
- d) “Konflikt rast për rast i interesit” është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë.
- e) “Konflikt i vazhdueshëm i interesit” është gjendja në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe /ose të shpeshtë në të ardhmen.

2. “Funksionar publik” është çdo person që kryen detyra dhe ushtron funksione publike.

3. “Epror i një funksionari publik” është një funksionar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik ose një organ i këtij institucioni, që ka kompetenca emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi këtë funksionar ose që i janë dhënë kompetenca të caktuara për zbatimin e këtij ligji.

4. “Person i lidhur me një funksionar” është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore me zyrtarin, sipas përcaktimit të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, (i ndryshuar).

5. “Parim i proporcionalitetit” (sipas pikës 12 të nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar), është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një funksionari, me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.

Neni 5

Fusha e zbatimit

Rregullorja, në Institucionin “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, përcakton norma të detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo funksionar publik, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje (sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, të lidhur me misionin dhe veprimtarinë e Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”).

Neni 6

Çastet paraprake të vendimmarrjes

Për qëllimin e kësaj rregulloreje:

- a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:

- i) hartimin e projektaktit nga funksionari ose funksionarët dhe dorëzimin e tij organit apo funksionarit kompetent për vendimmarrje;
- ii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, për këtë projektakt nga funksionarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;
- iii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo funksionar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;
- iv) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, të çdo funksionari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
- v) përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetëj përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projektkontratës në tërësinë e tyre;
- vi) çdo rast tjetër të lidhur me misionin dhe veprimtarinë e Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.

Neni 7

Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një funksionar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 6 të kësaj rregullore, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një funksionari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:
 - a) roli urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
 - b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive mbi misionin dhe veprimtarinë e Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.
 - c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së funksionarëve.
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, si dhe nga Drejtori.
4. Në secilën prej çasteve të mësipërme, funksionari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.

5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë funksionarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të funksionarit, vepohet sipas nenit 37 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Neni 8 Interesat private

1. Interesat private të një funksionari, duke patur parasysh natyrën e veçantë të funksioneve publike në Institucionin “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” (Drejtor, personel administrativ), janë, përgjithësisht, interesat që parashikohen nga neni 5 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, e konkretisht:

- a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
- b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
- ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
- d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- dh) marrëdhënie:
 - i) familjare apo të bashkëjetesës;
 - ii) të komunitetit;
 - iii) etnike;
 - iv) fetare;
 - v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
- e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendura në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një funksionari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë

7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe anashjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 dhe 4 të nenit 3 të ligjit të lartpërmendur, apo gjendemi para rasteve të papajtueshmërisë së funksionit të parashikuar në ligje të tjera.

Neni 9

Mënyra e kryerjes së detyrave publike dhe detyrimi për parandalimin e konfliktit të interesit

1. Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, funksionari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se funksionari nuk është i bindur për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë sipas ligjit.
2. Çdo epror apo institucion epror duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE RAST PAS RASTI TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve të interesave rast për rast

Neni 10

Deklarimi rast për rast i interesave private të funksionarit

1. Çdo funksionar, sipas përcaktimit të këtij termi në pikat 1, 2 e 3 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga funksionarët, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni epror. Deklarimi, si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur funksionari përfshihet në një vendimmarrje për një akt.

Neni 11
Identifikimi i interesave private të funksionarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit, për interesat private të funksionarit në Institucionin “Këshilli Kombëtar Kontabilitetit” është:
 - a) detyrë e çdo funksionari që ka dijëni;
 - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijëni dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat private të një funksionari, mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Neni 12
Lëshimi i autorizimit nga funksionari

1. Institucioni “Këshilli Kombëtar Kontabilitetit” vë në dispozicion të funksionarëve të saj modelin e autorizimit, që këta duhet të lëshojnë, brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës.
2. Autorizimi dorëzohet në Autoritetin Përgjegjës të Institucionin “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, i cili e administron atë gjatë gjithë periudhës që funksionari është në marrëdhënie pune në institucion.

Neni 13
Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti Qendror Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të kësaj rregulloreje, sipas hierarkisë janë:
 - a) Drejtori i Institucionit “Këshilli Kombëtar Kontabilitetit”;
 - b) Autoriteti Përgjegjës.
3. Autoriteti përgjegjës në Institucionin “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 9367 datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe në nenin 13 të kësaj rregulloreje, ngrihet me urdhër të Drejtorit të Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.
4. Në përshkrimin e pozicionit të punës, për detyrën e Autoritetit Përgjegjës të Institucionin “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, të vendoset si kriter dhe njohja e ligjeve për deklarimin

e pasurive dhe ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, i ndryshuar. Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni i Autoritetit Përgjegjës, njoftohet paraprakisht Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

Neni 14 Detyrat e autoritetit përgjegjës

1. Autoriteti Përgjegjës i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” kryen detyrat sipas udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. 1, datë 27.6.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësit e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike”, si dhe çdo detyrë tjetër sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.7.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe çdo akti nënligjor të miratuar në zbatim të tyre.
2. Autoriteti përgjegjës i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” kryen detyrat e mëposhtme:
 - a) mbledh dhe dokumenton interesat private të funksionarëve të Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”;
 - b) shpërndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t’u lëshuar nga administrata , sipas nenit 10 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe nenit 11 të kësaj rregulloreje;
 - c) krijon regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
 - ç) bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të funksionarëve, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur funksionarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
 - I. konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);
 - II. konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
 - d) kryen, me autorizim të Drejtorit të Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” verifikimin e interesave të deklaruara apo të padeklaruara të zyrtarëve, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë, sipas rastit Drejtorin e Institucionit;
 - dh) mbështet eprorin në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
 - c) përgatit guida, informon, këshillon e trajnon funksionarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesit;
 - ë) merr masa për të siguruar aksesin e informimit e publikut në të dhënat personale të funksionarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit;
 - f) në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse për çështjet juridike:

- I. marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi, funksionarëve përgjegjës, si dhe mbështesin Shkollën, në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshpërblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshpërblimit tek funksionarët përgjegjës;
 - II. orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të funksionarëve të Institucionit “Keshilli Kombëtar Kontabilitetit”, në përputhje me rregulloren dhe urdhrat e miratuara nga Drejtori i Institucionit;
 - III. shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga Drejtori i Institucionit, për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesit;
- g) mbështet ILDKPKI-në, në kryerjen e deklaramit periodik të interesave nga Drejtori i Institucioni ;
 - gj) njofton me shkrim ILDKPKI-në për rastet e largimit nga funksioni të funksionarëve (germa g) që mbartin detyrim për deklaramit të interesave private periodike në ILDKP;
 - h) njofton me shkrim ILDKP-në për rastet e emërimit të funksionarëve (germa g) që mbartin detyrim për deklaramit të interesave private periodike në ILDKP;
 - i) bën me dije funksionarët e Institucionit për çdo këshillë apo udhëzim të ILDKPKI-së;
 - j) mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të ILDKPKI-së në Institucionin “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”;
 - k) i paraqet Inspektoratit të Lartë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklaramit periodik;
 - l) ndjek e zbaton detyra të tjera, që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të titullarit të institucionit në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Neni 15

Administrimi i dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës

1. Dokumentacioni i përdorur nga autoriteti përgjegjës, në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, është dokumentacion zyrtar. Në rast largimi nga detyra, bëhet dorëzimi i gjithë dokumentacionit sipas rregullave të caktuara.
2. Me qëllim administrimin sa më të mirë të dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës, krijohen dosje të veçanta me përmbajtjen:
 - a) dosja nr. 1, me titull “Për aktet ligjore e nënligjore” duhet të përmbajë:
 1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
 2. Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;

3. Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
4. Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
5. Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”;
6. Kodin e Etikës të Institucionit “Këshilli Kombëtar Kontabilitetit”;
7. Ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
8. Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
9. Komentarë, urdhra, udhëzime dhe botime të tjera të ILDKP-së, ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim.

b) dosja nr. 2, me titull “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave” duhet të përmbajë:

1. Regjistrin e regjistrimit të konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
2. Autorizimet e plotësuara nga funksionarët për deklarin rast për rast të interesave;
3. Deklaratat e plotësuara nga funksionarët për konfliktin rast për rast të interesave;
4. Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të funksionarëve;
5. Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë.

c) dosja nr. 3, me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe të interesave të zyrtarëve, që mbartin detyrim për deklarin në ILDKP” duhet të përmbajë:

1. Regjistrin themeltar alfabetik nr. 1, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKP;
2. Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarin dhe konfirmimet e tyre;
3. Kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKP;
4. Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
5. Libri për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.

ç) libri i regjistrimit të shkresave të nisura dhe të ardhura nga ILDKP-ja.

Neni 16

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të funksionarëve të Institucionin “Këshilli Kombëtar Kontabilitetit”, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga Autoriteti Përgjegjës i Institucionin “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.

Neni 17
Regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit

Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistrohen identiteti i funksionarit, interesat privatë të tij, shkak për një konflikt interesi, thelbi i konfliktit, palët e interesuara, burimi i të dhënave, mënyra e marrjes dhe e verifikimit të tyre, si dhe vendimi që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykatat. Regjistrimi bëhet nga Autoriteti Përgjegjës i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.

Seksioni 2
Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave private

Neni 18
Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve bëhet sipas kërkesave të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
2. Zyrtarë në Institucionin “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, të cilët janë të detyruar sipas ligjit, të bëjnë deklarim të interesave private periodike janë:
 - a) Drejtori i Institucionit;
3. Gjithashtu, mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
4. Zyrtarët e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në ILDKP, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar “*Deklaratë pas largimit nga funksioni*”. Sektori i Financës dhe, Burimeve Njerëzore nuk mund të bëjnë dorëzimin e librezës së punës, të librezës së kontributeve shoqërore, të çdo dokumenti tjetër, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t’i takojnë zyrtarit, në rast se ky i fundit nuk plotëson këtë detyrim ligjor.

Neni 19
Llojet e interesave private që deklarohen periodikisht

Interesat private, që deklarohen periodikisht janë të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Neni 20
Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga funksionarët e Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” apo të institucioneve të varësisë, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:
 - a) funksionari, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues, dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
 - b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një funksionar tjetër, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i funksionarit është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) kur funksionari:
 - ose është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
 - ose vetëpërjashtimi i tij është i pamundur, sepse është i pamundur delegimi i kompetencave të funksionarit te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
 - ose për shkak se asnjëra nga zgjidhjet e parashikuara në nenin 23, pika 2 të kësaj rregulloreje nuk është e mundur;
 - b) dhe kur:
 - vendimet e funksionarit, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;
 - nuk është i mundur as transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);
 - nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, funksionari të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij funksionari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga eprori ose nga institucioni epror, të ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

Neni 21
Kufizimi i interesave private për parandalimin e
konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

1. Drejtori i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”:
 - a) Drejtori i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, nuk mund të lidhë kontrata ndërmjet Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit si institucioni publik nga njëra anë dhe nga ana tjetër shoqërisë/ve tregtare, shoqërisë së thjeshtë a ortakërisë, në të cilën Drejtori, zotëron aksione ose pjesë në kapital, pavarësisht nga sasia e aksioneve ose pjesëve të kapitalit që zotëron;
 - b) Drejtori i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” nuk mund të lidhë kontrata ndërmjet Institucionit nga njëra anë dhe një individ, personi fizik a juridik, apo ndonjë formë

tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur Drejtori, ka një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative;

c) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, nuk mund të zotëroje aksione në një organizatë fitimprurëse ose të jetë drejtues në një organizatë fitimprurëse, nëse sfera e veprimtarisë përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit dhe të kompetencës së tij për të vepruar ose për të nxjerrë akte;

d) nuk mund të punësohet me kohë të plotë në një detyrë tjetër me përjashtim të mësimdhënies dhe veprimtarive me natyrë shkencore;

2. Personeli administrativ i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”:

a) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të funksionarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar ose për të nxjerrë akte, me përjashtim të mësimdhënies dhe veprimtarive me natyrë shkencore;

b) nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, kur kjo shoqëri ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet, me sferën e juridiksionit të funksionarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar në Institucionin “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.

4. Pavarësisht përcaktimeve të mësipërme, ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, nga njëra anë dhe një individ, personi fizik a juridik, apo ndonjë forme tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen, njëkohësisht, kushtet e mëposhtme:

a) funksionari i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofertuesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës;

b) funksionari i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” ka një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 22

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një funksionar i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës.

a) “Dhurata”, sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr. 714, datë 22.10.2004, “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;

b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen funksionarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me

pozicionin dhe cilësinë e funksionit publik, që merr dhuratën.

2. Funksionari nuk duhet, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një funksionar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga funksionarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe hirarkisë së funksionit.
3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e zyrtarit.
4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004, “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.
5. Në asnjë rast funksionari i Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
6. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

Neni 23

Prania dhe kufizimi i interesave private të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me funksionarin, për kufizimet e interesave private të këtyre funksionarëve, të përcaktuar në nenin 21 të kësaj rregulloreje janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore, prindërit e funksionarit e të bashkëshortit/es.
2. Person i lidhur me funksionarin, për kufizimet e interesave private të funksionarëve të përcaktuar në nenin 22 të kësaj rregulloreje janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e funksionarit e të bashkëshortit/es, si dhe çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.
3. Ndalimet dhe kufizimet për funksionarët, të përcaktuara në nenin 21 të kësaj rregulloreje zbatohen edhe për personat e lidhur, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
4. Ndalimet dhe kufizimet për funksionarë, të përcaktuara në nenin 22 zbatohen edhe për personat e lidhur, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 24

Mënyrat e trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave

1. Mënyrat e trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave për funksionarët e Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit” bëhen sipas kreut IV të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

2. Disa nga mënyrat bazë të mënjanimin të konfliktit të interesit janë:

- t’i kufizohen funksionarit informacione të caktuara, që lidhen me ushtrimin e funksionit të tij;
- të mos i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;
- të mos lejohet që funksionari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
- të rishikohen ose të ndryshohen detyrat dhe kompetencat e funksionarit;
- të transferohet funksionari në një detyrë tjetër, që shmang konfliktin e interesave;
- të merren masat e nevojshme për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një funksionari në funksione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash;
- në rast të një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo mënyrë që kjo vihet re, të anulohen ose të revokohen, aktet e marra nga funksionari, sa më parë që të jetë e mundur, mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;
- anulimi ose revokimi i aktit mund të bëhet edhe kur gjykohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;
- anulimi ose revokimi i një akti nuk bëhet nga eprori i funksionarit, kur ai vlerëson se pasojat që mund të vijnë nga anulimi ose revokimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim ose revokim.

Neni 25

Sanksionet

Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, (i ndryshuar) dhe në këtë rregullore, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe/ose shkelje disiplinore dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar në nenin 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet, që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e funksionarëve.

Neni 26

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep funksionarëve të Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt, që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, apo ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e

përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

2. Në çdo rast që dispozitat e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, apo ato të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre, kanë prioritet dhe zbatohen drejtpërdrejtë.

Neni 27
Miratimi, shpallja, njoftimi

Kjo rregullore miratohet nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, i njoftohet Drejtorit të Institucionit dhe publikohet në faqen zyrtare të Institucionit “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit”.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

Tiranë, 20 janar 2023